

## Hyrje

Fondi BESA ka në funksion Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS) i cili është në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001. ISMS ndihmon në sigurimin e drejtimit dhe kontrollit të kuadrit që përdor organizata jonë për të mbrojtur asetet e saj të informacionit dhe për të zvogëluar riskun. Është e rëndësishme që të gjithë ata që janë të përfshirë në ISMS të kuptojnë rolin e tyre dhe se si aktivitetet që ata kryejnë kontribuojnë në përmbushjen e kërkesave të biznesit dhe sigurisë së informacionit dhe objektivave të përgjithshme të organizatës.

Krijimi dhe ruajtja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit dhe kompetencës për sigurinë e informacionit është një proces themelor brenda ISMS-së pasi ai mbështet shumë nga proceset e tjera në përdorim. Krijimi dhe mbajtja e një marrëdhënieje efektive me menaxhimin e biznesit, përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara, do të sigurojë që kontrollet e sigurisë së informacionit të zbatohen në mënyrat që dëshiron biznesi, duke kufizuar kështu ndikimin në performancën dhe rritjen e biznesit.

Ky dokument përcakton se si palët e interesuara brenda dhe jashtë Fondit BESA do të komunikojnë lidhur me çështjen e sigurisë së informacionit. Ai identifikon se cilët janë palët e interesuara dhe si do të krijohet një kanal efektiv komunikimi..

## Programi i Komunikimit

Aksesi I përgjithshëm për të siguruar angazhim dhe komunikim efektiv lidhur me ISMS-në brenda Fondit BESA-s është si më poshtë:

1. Identifikoni audiencën/palët e interesuara
2. Përcaktoni temat e duhura të komunikimit për çdo palë të interesuar
3. Bini dakord për metodat më të përshtatshme të angazhimit dhe komunikimit
4. Zbatoni programin
5. Merrni dhe veproni sipas reagimeve rreth suksesit të komunikimit, nëpërmjet të dhënave në planin e përmirësimit të vazhdueshëm

Këto hapa konsiderohen individualisht në seksionet e mëposhtme.

## Audienca

Ky program komunikimi u drejtohet palëve të interesuara, të brendshme dhe të jashtme, me kontratë dhe të përhershme, të cilët kanë një rol për të luajtur në funksionimin dhe zhvillimin e ISMS brenda Fondit BESA.

Palët e interesuara përfshijnë:

- Aksionerët
- Bordin Drejtues të Fondit BESA-s
- Komitetin Drejtues të Sigurisë IT të Fondit BESA
- Oficerin e Sigurisë IT të Fondit BESA
- Bordin e Menaxhimit të Kompanisë lokale Fondi BESA (BESA LCMB)
- Bankat e Nivelit të Dytë
- Konkurrentët
- Klientët
- Punonjësit e organizatës
- Kontraktorët që ofrojnë shërbime për Organizatën
- Organizatat shtetërore kombëtare
- Konkurrentët
- Media
- Autoritetet e BE-së
- Organizmi certifikues ISO 27001
- Auditori i jashtëm
- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## **Temat e Komunikimit**

Programi i komunikimit synon të komunikojë pikat kryesore të informacionit në fushat kryesore të mëposhtme:

- Mjedisi i biznesit në të cilin operon ISMS-ja, përfshirë ndryshime të rëndësishme dhe kur ato ndodhin
- Kuadri i përgjithshëm i ISMS-së duke përfshirë vizionin, politikat, planet dhe objektivat që duhet të arrihen
- Si lidhen masat e sigurisë së informacionit me nevojat e biznesit, si tani ashtu edhe në vazhdim?
- Si synohet ISMS-ja për të kapur dhe përmbushur kërkesat e biznesit për sigurinë e informacionit
- Kërkesat dhe kufizimet statutorë, rregullatore dhe kontraktuale brenda të cilave duhet të funksionojë ISMS-ja
- Përditësimet se si planet po përparojnë drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuara të ISMS-së
- Ndërgjegjësimi për çështjet dhe rreziqet e sigurisë së informacionit dhe qasja jonë për trajtimin e tyre

Niveli i detajeve të kërkuara në fushat e mësipërme do të ndryshojë sipas palëve të interesuara të përfshira.

## **Metodat e Komunikimit**

Ekzistojnë një numër i metodave të komunikimit të vendosura brenda BESA-s dhe këto do të përdoren aty ku është e mundur. Kjo përfshin:

1. Takimin e rregullt të ekipit (një herë në muaj)
2. Komunikimin me email

3. Komunikimin e thirrjeve telefonike. Faqja e internetit përdoret për komunikim të gjerë me publikun

4. Chat-in e brendshëm

Aty ku është e përshtatshme, do të vendosen metoda shtesë, në baza të përkohshme ose të përhershme, për të plotësuar ato tashmë të disponueshme.

Një përmbledhje e mënyrave se si do t'u komunikohet informacioni i nevojshëm palëve të interesuara është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Pala e Interesuar	Subjekti i Komunikimit	Methoda(t)	Shpeshtësia
Menaxhimi Ekzekutiv	Strategjia e Sigurisë së Informacionit Menaxhimi i riskut të nivelit të lartë Përcaktimi i politikës Raportimi i nivelit të lartë	Raportimet e bordit Menaxheri i Sigurisë së Informacionit; 1-1 me Drejtorin e Financës	Vjetore
Menaxhimi i departamenteve	Ndërgjegjësimi për sigurinë e informacionit Kërkesat e sigurisë për sistemet e reja IT Shqyrtimi i risqeve dhe çështjeve Shqyrtimet e shkeljeve të sigurisë	Grupi Drejtues IT Pikat specifike të axhendës në Takimet Ekipit të Menaxhimit të Lartë Bordi Këshillues për Ndryshimet IT	Vjetore
Përdoruesit IT	Komunikimi i Politikës së Sigurisë së Informacionit Kujtesa Ad-hoc kur ndodhin evente të rëndësishme si për shembull shkelje Paralajmërimet dhe ndërgjegjësimet	Buletinët Sondazhet Artikujt E-Zine Emaille	Vjetore
Personeli IT	Komunikimi i Politikës së Sigurisë së Informacionit Sugjerime për përmirësim Testimi i penetrimit	Konferencat Takimet e projektit	Vjetore
Bankat e nivelit të dytë	Politika e sigurisë së informacionit Kërkesat kontraktuale Detyrimet e furnizuesve Sugjerimet për përmirësim	Takimet e furnizuesve Takimet e projektit	Vjetore
Klientët	Qëllimi i ISMS-së Politika e sigurisë së informacionit Kontrollet në vend	E përshkruar në faqen e internetit	E vazhdueshme

Tabela 1 – Metodatat e komunikimit

## Procedurat e Komunikimit

Procedurat do të përcaktohen për secilën metodë komunikimi të identifikuar më lart në mënyrë që të kryhen në mënyrë të menaxhuar dhe të përsëritur.

Këto procedura janë referuar si më poshtë:

1. Verbalisht
2. Me postël
3. Me thirrje telefonike
4. Me takim

### Reagime lidhur me Komunikimin

Për secilën palë të interesuar, do të bihet dakort për një mbajtës të caktuar të marrëdhënies i cili është prërgjegjës për marrjen e komenteve lidhur me suksesin e komunikimit dhe menaxhimin e marrëdhënies në vazhdimësi. Mbajtësit e marrëdhënies tregohen në tabelën e mëposhtme.

<b>Pala e interesuar</b>	<b>Mbajtësi i marrëdhënies</b>
Menaxhimi Ekzekutiv	Kryefinancieri
Menaxhimi i Departamenteve	Oficeri i Sigurisë së Informacionit
Përdoruesit IT	Oficeri i Sigurisë së Informacionit
Personeli IT	Oficeri i Sigurisë së Informacionit
Bankat e Nivelit të Dytë	Oficeri i Sigurisë së Informacionit + Menaxheri IT
Klientët	Komiteti Drejtues IT
Palë të tjera të interesuara	Oficeri i Sigurisë së Informacionit

*Tabela 2 – Mbajtësit e marrëdhënies*

Në përgjithësi, shqyrtimet do të kryhen me secilën palë të interesuar të paktën një herë në vit. Ato mund të kryhen më shpesh në rast se menaxhimi i lartë do ta gjykojë të nevojshme.

Reagimet lidhur me suksesin e komunikimit do të mblidhen, vlerësohen, dhe po të jetë e nevojshme, do të përfshihen në program sa më shpejt që të jetë e mundur.

### Konkluzioni

Komunikimi efektiv me palët e interesuara është absolutisht themelor për suksesin e zbatimit të ISMS-së brenda Fondit BESA. Metodatat e komunikimit të përcaktuara në këtë dokument duhet të ndihmojnë për të siguruar që të gjitha palët e përfshira të jenë të mirëinformuara lidhur me çështjet e sigurisë së informacionit dhe të kenë mundësinë të japin komente si për kanalet e përdorura ashtu edhe për përmbajtjen e tyre.